

V E N D I M
Nr. 42, datë 17.1.1998

PËR MIRATIMIN E STATUSIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000; nr.17, datë 10.1.2003)

(I përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
 2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI I SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

KREU I
KRIJIMI DHE VENDI

Neni 1

(Shtuar fjalia e fundit me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (më poshtë SHKP) është institucion shtetëror qendror. Ai funksionon nëpërmjet zyrave rajonale dhe vendore të punësimit, agjencive vendore, si dhe qendrave të formimit profesional. Këshilli i Ministrave miraton simbolin e SHKP.

KREU II
QËLLIMI DHE VEPRIMTARIA

Neni 2

SHKP kryen veprimtari që synojnë:

- (i) përmbushjen e së drejtës të gjithë shtetasve banues në Shqipëri për t’u trajtuar me shërbime dhe për t’u mbështetur financiarisht në përpjekjet e tyre për gjetjen e një pune fitimprurëse të përshtatshme për cilësitë individuale dhe aftësitë profesionale;
- (ii) zbatimin dhe administrimin efikas të programeve dhe projekteve shtetërore, për të cilat ngarkohet me akte të posaçme ligjore a nënligjore;
- (iii) zhvillimin në përgjithësi të fuqisë punëtore të vendit nëpërmjet investimeve për rritjen e aftësisë punësuese dhe vetëpunësuese, të fleksibilitetit, lëvizshmërisë, aftësisë konkurruese etj.

Neni 3

Veprimtaria e SHKP përfshin, por nuk kufizohet në:

(i) shërbime të ndërmjetësimit në punë për të papunët që kërkojnë punë, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me paaftësi të ndryshme (më poshtë bashkërisht ("punëkërkuesit" dhe punëdhënësit);

(ii) shërbime të këshillimit profesional dhe të aftësimit për punësim a vetëpunësim për punëkërkuesit;

(iii) shërbimin e pagesës së papunësisë për individët që e përfitojnë atë;

(iv) subvencionimin e punëdhënësve që krijojnë vende të reja pune ose që punësojnë të rinj të sapodiplomuar;

(v) bashkëpunimin me pushtetin lokal për organizimin e punëve publike dhe përfshin në to të papunë që kërkojnë punë;

(vi) nxitjen e punëdhënësve që punësojnë persona me paaftësi;

(vii) formimin dhe riformimin profesional për punëkërkuesit dhe për të rinjtë në intervalin ndërmjet shkollës së mesme dhe të lartë;

(viii) kreditimin e punëdhënësve që ofrojnë trajnim dhe ritrajnim për të punësuarit e tyre;

(ix) mbështetje financiare të të papunëve që pranojnë të ndjekin kurset e trajnimit që u ofrohen;

(x) zbatimin dhe administrimin e programeve dhe projekteve që i ngarkohen me akte të posaçme ligjore dhe nënligjore;

(xi) zbatimin e marrëveshjeve a pjesëve të marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat ngarkohet;

(xii) shërbimet kundrejt pagesës dhe dhënies me qira të mjeteve që zotëron, individëve ose organizmave që kryejnë veprimtari të ngjashme apo bashkëpunojnë me SHKP-në;

(xiii) investimin e fondit rezervë për përfitimin e të ardhurave për fondin kombëtar të punësimit;

(xiv) grumbullimin, regjistrimin raportimin dhe përdorimin e informacionit për fuqinë punëtore në tërësi, papunësinë, veprimtaritë dhe ndërmarrjet punëdhënëse, individët ose grupet që kërkojnë shërbime etj.

Neni 4

Zbatimi i veprimtarive, të përmendura në nenin 3 të këtij statuti, bazohet në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", në aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të SHKP-së.

KREU III

FINANCIMI, BUXHETI, KONTABILITETI, BILANCI DHE RAPORTI VJETOR

Neni 5

SHKP-ja financohet dhe administron në mënyrë të pavarur fondin kombëtar të punësimit (FKP). Të ardhurat dhe shpenzimet e FKP-së rregullohen me dispozitat e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", statutin e fondit, rregulloren financiare të SHKP-së dhe aktet e tjera të posaçme ligjore a nënligjore.

Neni 6

Fondi garantohet nga buxheti i shtetit dhe shpenzohet në përputhje me buxhetin vjetor të SHKP-së.

Neni 7

(Ndryshuar me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Buxheti i investimeve vjetore të SHKP bëhet vetëm me aprovim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe në asnjë rast nuk kalon 10 për qind të buxhetit vjetor të shpenzimeve të SHKP.

Neni 8

(Shtuar paragrafi i dytë me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

SHKP merr masa për krijimin dhe mbajtjen e një fondi rezervë për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e papunësisë për një periudhë jo më pak se tremujore. Procedurat e hollësishme për krijimin, administrimin dhe investimin e fondit rezervë përcaktohen në statutin e fondit kombëtar të punësimit dhe në rregulloren financiare të SHKP-së. SHKP-ja krijon një fond në lekë dhe në një valutë për financimin e pjesëmarrjes në seminare, kurse specializimi brenda dhe jashtë vendit, pritje dhe përcjellje delegacionesh a specialistësh të huaj.

Neni 9

SHKP-ja mban regjistrat dhe librat financiarë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, statutin e FKP-së dhe rregulloren financiare të SHKP-së. Vit financiar i SHKP-së është viti kalendarik, 1 janar deri në 31 dhjetor.

Neni 10

(Shtuar togfjalësh me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Në fund të çdo viti financiar SHKP-ja bën bilancin, të cilin e përfshin në raportin vjetor të SHKP-së. Raporti vjetor bëhet publik menjëherë pas miratimit të tij nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

KREU IV

ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHKP-SË

Neni 11

(Hequr fjali me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

SHKP-ja përbëhet nga struktura që kryejnë funksione drejtuese, ekzekutive dhe shërbime. Drejtimi dhe ekzekutimi i veprimtarisë së SHKP-së kryhet nga këshilli administrativ tripalësh (më poshtë këshilli) dhe drejtori i përgjithshëm. Drejtoria e përgjithshme kryen veprimtari tekniko-administrative. Shërbimet realizohen nëpërmjet zyrave rajonale dhe vendore të punësimit, agjencive vendore, klubeve të punës, qendrave të formimit profesional, klubeve të biznesit dhe strukturave të tjera që krijohen e mbahen në funksioni të arritjes së qëllimit të veprimtarisë së SHKP-së dhe FKP-së.

Neni 12

(Ndryshuar togfjalësh dhe shtuar dy fjali me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Këshilli është organi më i lartë vendimmarrës i SHKP-së. Ai kryhesohet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. Në dhe përbëhet nga 13 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të

Ministrisë së Financave, Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, tre anëtarë nga organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës dhe tre anëtarë nga punëdhënësit më të përfaqësuar. Emërimi i anëtarëve të këshillit është i vlefshëm për 2 vite kalendarik. Miratimi i emërimit të anëtarëve bëhet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. Përfaqësitë e institucioneve shtetërore duhet të jenë në nivel zëvendësministër ose drejtor drejtorie”. Në fund shtohet fjalia “Këshilli ushtron veprimtarinë sipas rregullores së funksionimit të tij. Shpërblimi për pjesëmarrjen në mbledhjet e këshillit vendoset nga Ministri i Punës, dhe Çështjeve Sociale. në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

(Ndryshuar togfjalësh me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Këshilli mbledhet jo më pak se katër herë në vit. Mbledhja e këshillit thirret nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së ose një e treta e anëtarëve të tij dhe drejtohet nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. Mbledhja është e vlefshme kur në të janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit. Për mbledhjen mbahet procesverbal i rregullt dhe vendimet nënshkruhen nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale në raste të veçanta.

Neni 14

(Shtuar togfjalësh në pikën “v” dhe pika ‘vii’ dhe ndryshuar pika “vi” me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Këshilli ka këto kompetenca:

- (i) shqyrton projektet e akteve ligjore a nënligjore që do të propozohen në lidhje me veprimtarinë e SHKP-së dhe zbatimin e legjislacionit të punësimit, punës dhe formimit profesional, si dhe rregullore të tjera për veprimtarinë e SHKP;
- (ii) miraton rregulloren e organizimit e të funksionimit dhe rregulloren financiare;
- (iii) miraton bilancin, raportin vjetor dhe projektbuxhetin për vitin në vazhdim;
- (iv) vendos për investimet e fondeve;
- (v) vendos për kontratat dhe marrëveshjet e SHKP-së më të rëndësishme të SHKP sipas rregullores përkatëse.
- (vi) miraton strukturat e përgjithshme të SHKP dhe rregulloret e SHKP.
- (vii) krijon Komisionin e Kontrollit për kontrollin e veprimtarisë së tij.

Neni 15

(Ndryshuar me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv i SHKP-së. Ai emërohet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe përgjigjet para këtij të fundit për veprimtarinë e tij.

Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet kur:

- a) Jep dorëheqjen;
- b) Gjatë ushtrimit të detyrës dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë;
- c) Kur është në pamundësi fizike a mendore për të kryer funksionet e ngarkuara;
- d) Konkludohet paaftësia, me dy vlerësime negative të njëpasnjëshme të punës.

Neni 16
(Ndryshuar pika 4 me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- (I) drejton veprimtarinë e SHKP-së;
- (II) paraqet në këshill rregulloren e organizimit e të funksionimit, rregulloren financiare dhe akte të tjera që rregullojnë veprimtari të ndryshme të SHKP-së;
- (III) nxjerr rregullore të brendshme;
- (IV) Me miratim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale emëron drejtorët e drejtorive në SHKP, ata në nivel qarku dhe vendor si dhe drejtorët e institucioneve të tjera në vartësi të SHKP

Në këtë nen shtohen katër pikat e mëposhtme:

- emëron personel të niveleve të tjera të SHKP
 - propozon në Këshill strukturat e përgjithshme të SHKP
 - propozon në Këshill buxhetin vjetor, bilancin vjetor dhe detajimin e buxhetit
 - propozon dhe sipas rastit miraton programet kualifikuese për stafin në nivel qendror dhe lokal
- (V) emëron personel të niveleve të tjera të SHKP-së.

Neni 17

Drejtorja e Përgjithshme e SHKP-së organizohet në drejtori dhe sektorë. Ajo kryen zbërthimin, instruktimin, përgatitjen e personelit dhe kontrollin e detyrave që duhet të zgjidhin zyrat rajonale dhe vendore të punësimit, agjencive vendore, qendrat e formimit profesional dhe institucionet lokale në vartësi të SHKP-së. Drejtorja e Përgjithshme administron llogaritë qendrore të FKP-së dhe shpërndan instruksione për hartimin e projektbuxhetit.

Neni 18
(Shtuar paragrafi I dytë me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000; shtuar me vendimin nr. nr.17, datë 10.1.2003)

Zyrat rajonale dhe vendore të punësimit, agjencive vendore krijohen në SHKP dhe janë në vartësi të tij për zbatimin e detyrave në territorin, në të cilin ato ushtrojnë veprimtarinë. Zyra lokale e punësimit drejtohet nga drejtori i kësaj zyre, i cili e ushtron funksionin e tij në konsultim me këshillin lokal tripalësh.

Këshilli lokal trepalësh përbëhet nga përfaqësues të zyrës së punësimit, organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Të drejtat, detyrat dhe përbërja e këshillit lokal trepalësh përcaktohen nga këshilli administrativ tripalësh.

Neni 18/1
(Shtuar me vendimin nr. 17, datë 10.1.2003)

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave rajonale dhe vendore të punësimit

Zyra rajonale në nivel qarku ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Menaxhon zbatimin e politikave të punësimit në zyrat vendore të qarkut;
- Propozon forma të reja funksionimi për përsosjen e shërbimeve të punësimit në nivel qarku;
- Jep mbështetje profesionale në kualifikimin e stafit rajonal dhe vendor të shërbimeve

të punësimit;

- Organizon punën dhe monitoron zbatimin e detyrave në zyrat vendore;
- Miraton projekte për nxitjen e punësimit, nga të cilat përfitojnë ndërmarrjet e vogla;

vogla;

- Ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve të mriatuara në nivel qarku;
- Planifikon nevojat për trajnim në nivel rajonal;
- Mban rregullisht të dhëna për subjektet private, që zhvillojnë veprimtarinë në qarku;
- Planifikon nevojat për trajnim në nivel rajonal;
- Mban rregullisht të dhëna për subjektet private, që zhvillojnë veprimtarinë në qark;
- Bashkërendon ofertën me kërkesën për formim profesional, në nivel qarku;
- Bashkërendon punë e zyrave të punësimit në qark në qendrat publike të formimit profesional, për plotësimin e nevojave për formim që kanë punëkërkuesit e papunë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës;

profesional, për plotësimin e nevojave për formim që kanë punëkërkuesit e papunë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës;

- Harton, në mënyrë të hollësishme projektbuxhetin e zyrës rajonale dhe e dërgon për miratim në SHKP;

- Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit të zyrës rajonale;

- Harton dhe mbyll bilanci;

- Siguron të dhëna statistikore për programet, shërbimet dhe politikat e punësimit, në nivel qarku;

- Zbaton programin ekzistues statistikor dhe përpunon statistikën e qarkut;

- Propozon përmirësime të treguesve statistikore;

- Bën parashikimin afatshkurtër të tregut të punës, në nivel qarku;

- Jep të dhëna për organet e qeverisjes vendore (qark, komunë, bashki) dhe institucionet e tjera të qarkut, organizon takime dhe bashkëpunon me to, merr pjesë në studime të përbashkëta që i shërbejnë zhvillimit në nivel qarku;

- Njofton Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale për studimet në nivel qarku në fushën e punësimit, të tregut të punës, në shërbimet e punësimit, formimin profesional, nxitjen e punësimit, punët publike etj.

- Regjistron dhe vendos në vendet e punës punëkërkuesit që paraqiten dhe kërkojnë shërbime dhe ndihmën e zyrës së punësimit;

- Ofron shërbime të orientimit profesional, këshillime për punë dhe shërbime të tjera për shtetasit që paraqiten dhe i kërkojnë këto shërbime;

- Zbaton programe të mbështetje me të ardhura;

- Zbaton programe shtetërore të tregut të punës, si formim profesional, nxitje të punësimit, punë publike dhe programe të tjera, të ngarkuara me akte, ligjore e nënligjore;

- Bashkëpunon me institucione dhe organizma të tjera, që zbatojnë programe të ndryshme punësimi apo mbrojtjeje sociale;

- Krijon lidhje ndërmjet Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale me qarkun, për harmonizimin e politikave shtetërore të punësimit, në nivel qarku.

Zyra vendore në bashki dhe komunë ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Zbaton politikat e punësimit në zyrat vendore;

- Mban rregullisht të dhënat për subjekte private, që zhvillojnë veprimtarinë në nivel vendor;

- Bashkërendon ofertën me kërkesën për formim profesional, në nivel vendor;

- Harton, në mënyrë të hollësishme, projektbuxhetin e zyrës vendore dhe ia dërgon atë zyrës rajonale;

- Ndjek dhe kontrollon realizimin e buxhetit të zyrës vendore;

- Harton dhe mbyll bilanci;

- Siguron të dhëna statistikore për programet, shërbimet dhe politikat e punësimit, në nivel vendor;

- Zbaton programin ekzistues statistikor dhe përpunon statistikën në nivel vendor;
- Bën parashikimin afatshkurtër të tregut të punës, në nivel vendor, dhe ia dërgon atë zyrës rajonale dhe organeve të pushtetit vendor;
- Regjistron dhe vendos në vendet e punës punëkërkuarët që paraqiten dhe kërkojnë shërbime dhe ndihmën e zyrës së punësimit;
- Ofron shërbime të orientimit profesional, këshillime për punë dhe shërbime të tjera për shtetasit, që paraqiten dhe i kërkojnë këto shërbime;
- Zbaton programe të mbështetjes me të ardhura;
- Zbaton programe shtetërore të tregut të punës, si formim profesional, nxitje të punësimit, punë publike dhe programe të tjera, të ngarkuar me akte, ligjore e nënligjore;
- Bashkëpunon me bashkitë, komunat, institucionet dhe organizmatë të tjera, për zbatimin e programeve të ndryshme të punësimit apo të mbrojtjes sociale.

Neni 19

SHKP-ja, në vartësi nga programet që zbaton, mund të krijojë, transformojë a likuidojë struktura të ndryshme. Ndërtimi, përbërja dhe marrëdhëniet e ndërsjella të strukturave të SHKP-së përcaktohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të SHKP-së.

KREU V MARRËDHËNIET E SHKP-SË ME MINISTRINË

Neni 20

Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale. ushtron kontrollin dhe drejtimin e tij mbi veprimtarinë e SHKP me kompetencën e tij si kryetar i këshillit dhe të drejtën për të nxjerrë akte që ngarkojnë e rregullojnë veprimtarinë të caktuar brenda qëllimit dhe veprimtarisë të SHKP-së. SHKP-ja raporton, argumenton dhe paraqet për miratim paraprak te Ministri çdo iniciativë të re në marrëdhëniet e tij ndërkombëtare.

Neni 21

(Shtuar pika (iv) me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

SHKP-ja është përgjegjëse për raportimin në strukturat e autorizuar të ministrisë lidhur me:

- (i) papunësinë në tërësi, strukturën, shkaqet, prirjet e saj;
- (ii) statusin, ecurinë e zbatimit, buxhetet, efikasitetin, rezultatet e veprimtarive të SHKP-së dhe programeve shtetërore të zbatuara apo në zbatim e sipër nga ai;
- (iii) gjendjen, zhvillimin dhe ndryshimet në forcën aktive të punës në vend.
- (iv) veprimtarinë e saj, realizimin e buxhetit, realizimin e programeve të punës, informacionin statistikor për nivelin qendror dhe lokal.

Neni 22

(Ndryshuar me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

SHKP paraqet në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale propozimet për projektbuxhetin, ndryshimet në legjislacion, çdo iniciativë për projekte, studime dhe bashkëpunime të reja si dhe për papunësinë dhe tregun e punës.

Neni 23

(Shtuar paragrafi i parë me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

SHKP bashkëpunon me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Shërbimin Social Shtetëror dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës për bashkërendimin e koordinimin e aktiviteteve.

SHKP-ja bashkëpunon, lidh marrëveshje dhe kryen veprimtari me organizatat joqeveritare shqiptare apo të huaja që kryejnë veprimtari të ngjashme me të.

Neni 24

(Ndryshuar me vendimin nr. 263, datë 25.5.2000)

Shërbimi Kombëtar i Punësimit kontrollon institucionet publike dhe private për aktivitetin e tyre dhe i propozon Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale autorizimin e tyre.

Neni 25

Ky statut hyn në fuqi menjëherë.